



**UNIVERSITETI
"ALEKSANDËR MOISIU"**



**UNIVERSITETI
"UKSHIN HOTI"**

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt.	18.11.2019
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-459

Nr. 1899 Prot.
Datë 15/11/2019

Nr. 459 Prot.
Datë 18/11/2019

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
DHE
UNIVERSITETIT "UKSHIN HOTI" PRISHTINË**

Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, i quajtur më poshtë UAMD dhe Universiteti "Ukshin Hoti", Prishtinë, Kosovë, duke qenë të vetëdijshëm për përfitimet reciproke të dy institucioneve, që rrjedhin nga vendosja dhe zhvillimi i marrëdhënieve dhe bashkëpunimit, nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi me qëllim zhvillimin e kooperimit akademik dhe promovimin e mirëkuptimit mes dy universiteteve.

Qëllimi i bashkëpunimit

UAMD dhe Universiteti "Ukshin Hoti" bien dakord të zhvillojnë aktivitetet e mëposhtme në fushat akademike me interes të përbashkët duke u bazuar në principet e barazisë dhe reciprocitetit:

- Shkëmbim stafi akademik dhe/ose administrativ;
- Shkëmbim studentësh të cikleve të ndryshme studimi për periudha semestrale studimi ose për periudha të praktikave;
- Aktivitete dhe publikime të përbashkëta në kërkim shkencor;
- Pjesëmarrje në seminare, konferenca, evenimente dhe takime akademike;
- Shkëmbim të materialeve akademike si dhe informacione të tjera të nevojshme;
- Programe të veçanta akademike afatshkurtra.

Kushtet dhe mënyra e bashkëpunimit për secilin prej aktivitetëve të lartpërmendura që do të implementohen në saj të kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi do të diskutohet dhe vendoset me shkrim përpara fillimit të aktivitetit.

Rinovimi, përfundimi dhe amendimet

Kjo marrëveshje bashkëpunimi do të jetë në fuqi për një periudhë 5 (pesë) vjeçare që nga data e nënshkrimit nga të dyja palët, me mirëkuptimin që mund të përfundojë edhe përpara këtij afati me iniciativën e njëres prej palëve, duke njoftuar me shkrim 12 (dymbëdhjetë) muaj më parë. Gjithashtu kjo Marrëveshje Bashkëpunimi mund të shtyhet në afat apo amendohet në pjesë të veçanta të saj, nëse të dy palët bien dakord me shkrim.

Për Universitetin "Aleksandër Moisiu"

Rektori
Prof. Dr. Ksenela Sotirovski



Për Universitetin "Ukshin Hoti"

Rektori
Prof. Asoc. Dr. Ismet Temaj

